



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the
General Secretary

DATË/A:	05.09.2024
REFERENC-Ë:	24/5101/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Baruti Group" Sh.p.k. Mitrovicë Transportin dhe deponimin e mbeturinave nga demolim konstruktimi në Llaushë, K.K. Podujevë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Autorizim Mjedisor

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 24/5101/517/DMMU-MMPHI, për Autorizim Mjedisor për transportin dhe deponimin e mbeturinave nga demolim konstruktimi në parcelën katastrale P-71712044-00099-0 Z.K. Llaushë, K.K. Podujevë dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

- Vendimi për Autorizim Mjedisor për transportin dhe deponimin e mbeturinave nga demolim konstruktimi në parcelën katastrale P-71712044-00099-0 Z.K. Llaushë, K.K. Podujevë.

Me respekt,

Faqe 1 nga 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/5101/MMPHI
Datë: 05.09.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 33 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/21 për Autorizim Mjedisor dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 03/22 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 01/21, për Autorizim Mjedisor, nxjerr këtë:

V E N D I M
Për Autorizim Mjedisor



Kompania "Baruti Group" Sh.p.k. Mitrovicë pajiset me Autorizim Mjedisor për veprimtarinë: transportin dhe deponimin e mbeturinave nga demolim- konstruktimi i "Siloseve".

Mbeturinat e krijuara nga demolim- konstruktimit të "Siloseve" sipas Vendimi për Leje rrënimi nga MMPHI, numri i vrojtimit të lejes :K.III-01/2024, datë:22.04.2024 dhe deponimin e tyre në parcelën P-71712044-00099-0 Z.K. Llaushë, K.K. Podujevë, nën kushtet si vijon:

- Gjatë realizimit të projektit ti përmbahet obligimeve të prezantuara në raportin për Autorizim Mjedisor;

Faqe 2 nga 4

- T'i përmbahet dispozitave të U.A. Nr. 07/2015, për Menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi objekteve ndërtimore;
- Bartja e mbeturinave të bëhet në përputhje nenin 11, paragrafin 1 dhe 2 të U.A. Nr.07/2015 për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve të ndërtimit;
- Mbeturinat nga demolim konstruktivi gjatë transportit me kamion të mbulohen me foli;
- Bazuar në vendimit nr.01-353/01-0087368/18, të lëshuar me dt: 02.11.2018, nga Komuna e Podujevës kompania "Baruti Group" Sh.p.k. Mitrovicë, pas mbushjes së gropave me mbeturina nga demolim konstruktivi në parcelën katastrale P-71712044-00099-0 Z.K. Llaushë, K.K. Podujevë duhet të bëjë gjelbërimin e hapësirave të deponisë.

Mbikëqyrja administrative për menaxhimin e mbeturinave nga ND, bëhet sipas nenit 61 dhe 62 të Ligjit për Mbeturina, përmes Inspektoratit Mjedisor të MMPHI-së dhe Inspektoratit të Komunës.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për Autorizim Mjedisor për operatorin "Baruti Group" Sh.p.k. Mitrovicë, për veprimtarinë: transportin dhe deponimin e mbeturinave nga demolim konstruktivi në parcelën kadastrale P-71712044-00099-0 Z.K. Llaushë, K.K. Podujevë, është konstatuar se operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ Nr. 01/21 për Autorizim Mjedisor dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 03/22 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 01/21.

Kërkesës për Autorizim Mjedisor i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Raporti i Autorizimit mjedisor 1 kopje në formë të shkruar;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Certifikatën e pronësisë dhe kopjen e planit me koordinata për vendin ku zbatohet projekti;
- Pëlqimi nga Komuna e Podujevës me nr.10-334/07-0053293/24, dt:13.08.2024; për caktimin e lokacionit për hedhjen e mbeturinave inerte në parcelën; kadastrale P-71712044-00099-0 Z.K. Llaushë, K.K. Podujevë;
- Vendimi Kuvendi i Komunës së Podujevës për caktimin e lokacionit për hedhjen e mbeturinave inerte në parcelat kadastrale P-71712044-00099-0 dhe P-71712038-00347-0;
- Vendimi për Leje rrënimi nga MMPHI, numri i vrojtimit të lejes :K.III-01/2024, datë:22.04.2024
- Kontrata e noterizuar në mes të aplikuesit dhe operatorit që e zbaton projektin kur aktiviteti kryhet nga kompania shërbyese/operatori
- Fatura e pagesës së tarifës së shërbimit për Autorizim Mjedisor.

Operatori do të monitorohen nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të Inspektoratit Mjedisorë të MMPHI-së dhe Inspektoratit të Komunës.

Operatori, duhet të njoftoj paraprakisht Inspektoratin Mjedisorë të MMPHI-së dhe Inspektoratin e Komunës para fillimit të punëve në lidhje me deponimin e mbeturinave nga demolim konstruktivi.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, Autorizimi Mjedisor do të anulohet.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Podujevë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Inspektoratit Komunal- Podujevë;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së